



**KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË
UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, solli vendim, me të cilin kryhet **rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 1,64 %** në raport me vendimin e datës 04.01.2021.

"Vendimi i sotshëm, me të cilin kryhet rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës, është rezultat i çmimeve të rritura të bursës nga java e kaluar. Rritja e të gjitha çmimeve referente në bursat botërore vijon pas deklaratës së ministrit të energjetikës të Arabisë Saudite, princit Abdulaiz bin Salman, i cili deklaroi se Arabia Saudite do t'i tejkalojë kuotat e shkurtimeve, për të cilat kanë rënë dakord, me qëllim që ta ruajë ekonominë e saj dhe tregun me naftë, me çka nga e martja, çmimi i naftës Brent në bursa është rritur për 5% dhe i njëjti la vlerë prej mbi 53 USD \$/t", deklaroi Marko Bislimoski, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 rriten për 1,00 denar/litër, ndërsa çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT (D-E V) dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) rriten për 0,50 denarë/litër, në raport me çmimet e shitjes me pakicë të përcaktuara me vendimin e datës 04.01.2021.

Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU rritet për 0,888 den/kg dhe do të jetë 29,651 den/kg.

Nga data 12.1.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

Benzinë për motorë	EUROSUPER BS – 95	62,00 (denarë/litër)
Benzinë për motorë	EUROSUPER BS -98	63,50 (denarë/litër)
Naftë për motorë	EURODIZEL BS (D-E V)	53,50 (denarë/litër)
Vaj për Djegie	Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	53,00 (denarë/litër)
Mazut M-1 SU		29,651 (denarë/kilogram)

Në periudhën e kaluar shtatëditore **të gjitha çmimet referente në bursat botërore, shënojnë rritje:** te benzina për 5,431 %, te nafta për 2,43 %, te vaji ekstra i lehtë për 2,872 % dhe te mazuti për 5,156% .

Në të njëjtën periudhë **kursi i denarit në raport me dollarin është më i ulët** për 0,494%.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 12.1.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së (https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en datë 4.1.2021), janë dhënë në tabelën në vijim:

	Eurodizel (EUR)	EUROSUPER BS-95 (EUR)
Maqedonia e Veriut	0,860	0,990
Austria	1,043	1,072
Bullgaria	0,938	0,944
Kroacia	1,186	1,215
Gjermania	1,112	1,281
Greqia	1,160	1,432
Italia	1,304	1,428
Hungaria	1,073	1,023
Slovenia	1,067	1,003

11.1.2021